

Thirrje për Ekspert për Trajnim në Kujdesin Afatgjatë

Konsulencë	Ekspert për Trajnim në Kujdesin Afatgjatë
Kohezgjatja e shërbimit	Prill-Qershor 2025
Zona e projektit	Bashkia Tiranë
Data e mundshme e fillimit të punës	10 Prill 2025

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS kërkon të kontrakttojë një videograf dhe montazhier për të mbështetur fushatën e ndërgjegjësimit për fuqizimin e familjes, dhe formave alternative të kujdesit në Bashkinë Korçë dhe Durrës, në kuadër të programit Global Accelerator for Jobs and Social Protection “Lifelong Empowerment and Protection in Albania (LEAP Albania) mbështetur nga UNDP. Kjo konsulencë synon përzgjedhjen e dy ekspertëve për zhvillimin dhe realizimin e një programi trajnimi gjithëpërfshirës, që kombinon komponentët teorikë me aftësi praktike në fushën e kujdesit për të moshuarit dhe personat në nevojë për mbështetje afatgjatë.

Rreth Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS (shkurtimisht NISMA ARSIS) është një organizatë jofitimprurëse, e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. NISMA ARSIS është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Mision i NISMA ARSIS është angazhimi për avancimin e të drejtave të fëmijëve, të rinjve dhe familjarëve të tyre që përballen me vulnerabilitet, duke ofruar shërbime gjithëpërfshirëse dhe duke lehtësuar integrimin me dinjitet të tyre në shoqëri. NISMA ARSIS advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbim ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabël.

Përshkrimi i Projektit

Projekti po zbatohet në Bashkinë Tiranë “Fuqizimi i Kujdesit Afatgjatë përmes Mbështetjes Sociale dhe Punësimit për Komunitetet Vulnerabël në Bashkinë e Tiranës” në kuadër të programit Përshpejtuesi Global për Punësimin dhe Mbrojtjen Sociale: Fuqizim dhe Mbrojtje gjatë gjithë Jetës në Shqipëri (LEAP Albania) i financuar nga UNDP. Qëllimi i projektit është të hartojë dhe zbatojë një model lokal për përmirësimin e aksesit në shërbimet e integruara të kujdesit social për individë vulnerabël në nevojë për kujdes afatgjatë (fëmijë, të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara) në Bashkinë e Tiranës. Si dhe të promovojë punësueshmërinë e grave vulnerabël në sektorin e kujdesit afatgjatë, përmes ofrimit të këshillimit intensiv dhe lidhjes me programet e punësimit, në bashkëpunim me zyrën e NAES në Tiranë.

Nën mbështetjen dhe bashkëpunimin me ekipin koordinues të programit, **Konsulenti, do të ketë këto detyra dhe përgjegjësi:**



ARSIS

Hartimi dhe zbatimi



- Hartimi dhe zbatimi e programit të trajnimit në bashkëpunim me stafin projektues dhe partnerët lokalë të kujdesit;

- Realizimin e 24 sesioneve trajnimi secili (në total 48 sesione), të ndara përgjatë 3 muajve;
- Zhvillimin e moduleve që përfshijnë: kujdesin ndaj pacientit, komunikimin ndërpersonal, empatinë dhe teknikat praktike të kujdesit;
- Hartimin dhe zbatimin e planit individual të trajnimit për secilin pjesëmarrës, bazuar në një vlerësim të parë të aftësive dhe objektivave të tyre;
- Bashkëpunimin me menaxherët e rasteve për të siguruar mbështetje të vazhdueshme për pjesëmarrësit;
- Sigurimin që trajnimi të jetë gjithëpërfshirës dhe i përshtatshëm për gratë me kufizime sociale dhe ekonomike;
- Përgatitjen e një raporti përfundimtar mbi ecurinë dhe rezultatet e trajnimit.

Kualifikimet dhe aftësitë e kërkuara:

- Diplomë universitare në infermieri, shkenca sociale, psikologji, edukim ose fusha të ngjashme;
 - Eksperienca e mëparshme në trajnime profesionale dhe/ose në fushën e kujdesit afatgjatë;
 - Njohuri të mira mbi nevojat dhe sfidat e grupeve vulnerabël, sidomos grave në ndihmë ekonomike;
 - Aftësi të shkëlqyera komunikimi, organizimi dhe lehtësimi të grupeve;
 - Aftësi për të punuar në mënyrë bashkëpunuese me institucionet vendore dhe palët e interesuara.
- ***Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve:*** Të gjithë personat që punojnë me programet e Nisma ARSIS janë të detyruar të respektojnë politikat e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, rregulloren e brendshme të Nisma ARSIS, kodin e sjelljes, Legjislacionin e plotë për Mbrojtjen e Fëmijëve si dhe çdo dokument tjetër për të cilin duhet të ketë dijeni.

Koha e mundshme e fillimit të punës është 10 prill 2025.

Kohëzgjatja e ofrimit të shërbimit është përgjatë periudhës prill -qershor 2025

Kjo ekspertizë përfshin 48 ditë pune, 2 ekspertë, 2 ditë në javë për 4 javë në muaj, për 3 muaj; gjithsej 48 sesione trajnimi.

Procedura e aplikimit:

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për këtë thirrje duhet të dërgojnë me email :

1. CV-në;
2. Letër angazhimi/disponueshmërie;
3. Ofertën financiare.

brenda dates **28 mars 2025** në info@nisma-arsis.org .

Procedura e Vlerësimit:

Zgjedhja e ekspertit do të bazohet në:

- se sa mirë aplikimi përmbush kërkesat e përcaktuara në termat e referencës,
- eksperiencat e relevante të mëparshme
- oferta financiare
- gjithashtu edhe bazuar në tabelën e vlerësimit të mëposhtëm.

Kriteret e vlerësimit	Vlerat në %
Kualifikime	30%
Eksperiencë pune	50%
Oferta financiare	20%

Ju lutemi, në vemendjen tuaj që:

- vetëm personat e përzgjedhur për intervistë do të kontaktohen.